



25 Maj May | 02 Qershor June | 2011

REMUSICA

FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS PËR MUZIKËN E RE
PRISHTINA INTERNATIONAL CONTEMPORARY MUSIC FESTIVAL



REMUSICA
Edicionet | Editions
2002-2010

2002



2003



2004



2005



2006



REMUSICA



2007



2008



2009



2010



10 VJET TË REMUSICA-S

(Fati i muzikës së Re, fati i kompozitorit të sotëm, fati i veprës së tij)

Qëllimi themelor i REMUSICA-s në këto dhjetë vitet e jetës së saj, ishte popullarizimi i muzikës bashkëkohore e në kuadër ta saj, popullarizimi i krijimtarisë së kompozitorëve kosovarë. Në qendër të vëmendjes sonë, në mënyrë të vazhdueshme, ka qenë pra vepra bashkëkohore. Kemi konsideruar me arsye se hapi i parë drejt ndryshimit të pozitës së veprës së kompozitorit modern është aktualizimi i veprës së tij dhe, në këtë drejtim, gjetja e formave sa më të mira për këtë aktualizim

Pikërisht nga kjo bindje unë me miqtë e mij - Baki Jasharin, Mendi Mengjiqin, Ilir Bajrin, Zana Shuteriqin, dhe Valton Beqirin, në vjeshtën e vitit 2001, pas diskutimeve të shumta vendosëm që të fillojmë pregaditjet për organizimin e një festivali të muzikës moderne të emërtuar fillimisht Skena Muzikore e Re e Prishtinës (si aludim në Festivalin e ngjashëm që ekzistonte në Kosovë për dy dekada me rradhë) e më pastaj e emërtuam me emër sinjifikativ ReMusica (Muzika e Re). Kështu, Festivali Ndërkombëtar i Prishtinës - REMUSICA nisi jetën e saj ne pranverën e vitit 2002.

(Artistë dhe formacionet me renome)

Ishim të sigurt se rrugë më e mirë drejt popullarizimit të muzikës së re është realizimi sa më cilësor i veprave të reja. Kjo ka nënkuptuar bashkëpunimin me artistë dhe ansamble të reputacionit të lartë, të cilët me kompetencë profesionale për këtë muzikë, do të jetësojnë veprat e zgjedhura. Siq mund të vërehet edhe nga programi i këtij edicioni, kjo kjo rrugë nuk braktiset. Këtë vit në REMUSICA vjen Ansambli me renome nga Kroacia (I Solisti Di Zagreb), që gëzon reputacionin e një prej ansambleve më cilësor në rajon në katër dekadat e fundit;

vjen pianistja me renome nga Japonia, Aki Takahashi artiste me autoritet, për të cilën kanë shkruajtur vepra kompozitorët më të medhenj të shekullit XX; vjen virtuoz i ri në trompë nga Franca, Romain Leleu, që në vitin 2009, është shpallur artisti i vitit në këtë vend; klarinetistja atraktive nga SHBA-ja Krista Martyneze, me performancën e saj multimediale; Kalei Duo (fizarmonikë-flaut) nga Italia /T. Ciccaresse e G. Fasseta/; Trioja e talentëve kulminant gjerman (Belli-Fischer-Rimmer); vjen pas dy vitesh Petrit Çeku, artisti kosovar që ka bërë hapin më të madh në vitet e fundit në skenën internacionale; mexosopranoja Flaka Goranci, sopranoja Besa Llugiqi dhe Admir Doçi, të cilët do të na prezantojnë literaturën atraktive vokale hispanike e shumë të tjerë.

(Kujdesi për krijimtarinë kosovare)

Kapitull iu veçantë i REMUSICA-s është pamëdyshje kujdesi që ajo i kushton nxitjes dhe realizimit të krijimtarisë kosovare. Dihet mirefilli se artistët që vijnë nga jashtë, ne programet e tyre përfaqësojnë dodmosdo vepra të kompozitorëve kosovarë. Dhe në këto dhjetë vite janë realizuar një numër impresiv e veprave kosovare. Është bërë (audio)inçizimi i të gjitha veprave. Sot, REMUSICA, posedon Arkivin më të madh të (audio) inçizimeve të muzikës kosovare të dekadës së fundit. Me këtë edicion ne mbarojmë një dekadë të punës sonë me shpresë se ky festival edhe më tutje do të jetë manifestim kyq për zhvillimin i krijimtarisë moderne dhe bosht i jetës muzikore të Prishtinës



Rafet RUDI,
Drejtor i REMUSICA-s



REMUSICA

10 YEARS OF REMUSICA

“The fate of new music, the fate of today’s composer and fate of his work”

The main aim of REMUSICA, over these ten years of its existence, was popularization of contemporary music and, with it, popularization of works of Kosovar composers. The contemporary musical piece has always been in the centre of our attention. We justly considered that the best step to be undertaken towards changing the position of contemporary works, was to keep their work alive, and to find ways how to achieve this.

Starting from this principle, we and my friends - Baki Jashari, Mendi Mengjiri, Ilir Bajri, Zana Shuteriqi, and Valton Beqiri, in autumn of 2001, after many long discussions, decided to start preparation for organizing a festival of contemporary music, first as New Musical Scene of Prishtina (as a reference to a similar festival that existed in Kosovo for two decades) and then we decided to name it with the more significant ReMusica (New Music). Thus, International Festival of Prishtina – REMUSICA, came to life in spring 2002.

(Renowned artists and formations)

We were assured that the best way to make popular new music was via realising in best possible and qualitative ways new musical works. This meant that cooperation with renowned artists and ensembles - who are competent in giving life to the selected musical works - was necessary. As one can notice in the program of this years’ edition, this method is still being practiced. This year REMUSICA brings one of the most celebrated ensembles in the region for the last four decades, I Solisti di Zagreb from Croatia; then the prominent pianist from Japan, Aki Takahashi, who is an authoritative artist that great

composers of the 20th century have composed for; the new trumpet *virtuoso* from France, Romain Leleu, who was the artist of the year in France in 2009; the attractive clarinetist from USA, Krista Martynetz, with her multimedia performance; Kalei Duo (accordion - flute) from Italy /T. Ciccarese and G. Fasseta/; the talented German trio (Belli-Fischer-Rimmer); the Kosovo artist who achieved great success in the international scene, Petrit Çeku, returns after two years; also, mezzo-soprano Flaka Goranci, sopranos Besa Llugiqi and Admir Doçi, will present attractive vocal literature from the Hispanic canon, and many others.

(Care for Kosovar works)

A special caption of REMUSICA is its dedication to realisation and stimulation of Kosovar new music works. It is well known that international artists that come to our festival include Kosovar works in their program. And during these ten years, an impressive number of Kosovar works has been realised. There has also been an audio recording of all works. Today, REMUSICA, has the biggest audio archive of Kosovar music of the last decade.

With this edition we are closing a decade of our work with hope that this festival will continue being key for the development of contemporary music, and centre of musical life in Prishtina.

Rafet RUDI,
Director of REMUSICA

PROGRAM 2011

25 MAJ | MAY
E MËRKURË | WEDNESDAY

20 h 00 HAPJA / OPENING / Teatri Kombëtar / National Theatre

TRIO GJERMANI / GJERMANY

Fredric Belli trombon / trombone

Johannes Fischer perkusione /percussions

Nicholas Rimmer piano

Claude Debussy / Georg Aperghis / Drinor Zymberi / Frank Martin / Enrique Granados / Astor Piazzolla

26 MAJ | MAY
E ENJTE | THURSDAY

20 h 00 Konkert Vokal / Vocal Concert Kisha 'Shën Ndou' / Catholic Church 'St. Anthony's'

Flaka Goranci mexosoprano / mezzosoprano

Besa Llugini soprano

Admir Doçi kitarë / guitar - SHQIPERI / ALBANIA

Joaquin Rodrigo / Daniel Akiva / Endri Sina / Joaquin Turina /
Carlo Domeniconi / Fernando Sor

27 MAJ | MAY
E PREMTE | FRIDAY

20 h 00 Recital / Kisha 'Shën Ndou' / Catholic Church 'St. Anthony's'

Romain Leleu trompë / trumpet – FRANCE

Misbah Kaçamaku piano

Alexander Arutunian / Georges Enesco / Kushtrim Gashi / Maurice Ravel / Alexander Goedicke /
Philippe Hersant / Valton Beqiri / Philippe Gaubert / Jean Baptiste Arban

28 MAJ | MAY
E SHTUNË | SATURDAY

12 h 30 Konkert / Concert Kisha 'Shën Ndou' / Catholic Church 'St. Anthony's'

Tito Ciccacese flaut /flute

Gianni Fassetta fizarmonikë / accordeon – ITALI / ITALY

Astor Piazzolla / Paolo Pessina / Ennio Morricone / Zeqirja Ballata / Massimo di Gesu / Nino Rota /
Teresa Procaccini /Mario Pagotto / Richard Galliano

19 h 30 Konkert / Concert Kisha 'Shën Ndou' / Catholic Church 'St. Anthony's'

Kori i Filharmonisë së Kosovës / Kosova Philharmonic CHOIR

Rafet Rudi dirigjent / conductor

Eric Whitacre / John Tavener / Mendi Mengjiqi / Rafet Rudi / Thoma Simaku / Leonard Bernstein /
Benjamin Britten

29 MAJ | MAY
E DIEL | SUNDAY

20 h 00 Konkert / Concert Salla e Kuqe / Red Hall

Orkestra e Filharmonisë së Kosovës / Kosova Philharmonic ORCHESTRA

Jouni Somero piano – FINLANDË / FINLAND

René Gulikers dirigjent / conductor – HOLANDË / HOLLAND

Felix Mendelssohn Franz Liszt / Giel Vleggaar / George Gershwin



REMUSICA

30 MAJ | MAY
E HËNË | MONDAY

20 h 00 Recital Salla e Kuqe / Red Hall
Petrit Çeku kitarë / guitar
Manuel Ponce / Mario Castelnuovo-Tedesco / Manuel de Falla / Joaquín Rodrigo / Bashkim Shehu
/ Astor Piazzolla

21 h 30 Koncert multimedial / Multimedial concert
Krista Martynes clarinet & live electronic & live video - SHBA / USA
Karlheinz Essl / Ana Sokolovic / Steve Reich / David Lang / Giancinto Scelsi / Donika Rudi / Julien-
Robert Legault Salvail

31 MAJ | MAY
E MARTË | TUESDAY

12 h 30 Promovim / Promotion ART Center
Libri "Esat Rizvanolli – kompozitor" nga Sh. Hoxha / "Esat Rizvanolli – composer" from Sh. Hoxha
Referuese / Referent: **Reze Kryeziu** muzikologe / musicologist

20 h 00 Recital Salla e Kuqe / Red Hall
Aki Takahashi piano - Japan
Eric Satie / Toru Takemitsu / Makiko Nishikaze / Drinor Zimberi / Rafet Rudi / Franz Schubert /
Morton Feldman / John Cage / Henry Cowell

01 QERSHOR | JUNE
E MËRKURË | WEDNESDAY

12 h 30 Koncert Pedagogjik / Miniatura për Piano Salla e Filharmonisë / Philharmony Hall)
Pedagogic Concert / Miniatures for Piano
Në bazë të këngëve popullore shqipe
Based on Albanian folk songs
Zeqirja Ballata / Dafina Zeqiri / Kreshnik Aliçkaj / Drinor Zymberi / Kushtrim Gashi / Fahri Beqiri /
Vasil S. Tole / Valton Beqiri / Fatos Lumani / Muhamed Bislimi

20 h 00 Koncert / Concert Salla e Kuqe / Red Hall
Ensemble **I Solisti di Zagreb**
Petrit Çeku kitarë / guitar
Borivoj Martinić – Jerčić violin / violin
Antonio Vivaldi / Ivo Josipovic / Baki Jashari / Leo Brouwer

02 QERSHOR | JUNE
E ENJTE | THURSDAY

12h30 Podiumi i hapur / Open podium Biblioteka Kombëtare / National Library
Artistët e rinj & Kompozitorët / Young Artists & Composers

28-29 may ART Center

European CONFERENCE around Music Festivals / KONFERENCA Evropiane rreth Festivaleve

Debatin e udhëheqë: Besa LUZHA, Kandidatë për Doktor në Edukim- Universiteti i Londrës
Referent: Besa LUZHA, Candidate for Doctor in Education – University of London

25 MAJ
MAY 2011

E MËRKURË | WEDNESDAY

20h00 KONCERT | CONCERT Teatri Kombëtar | National Theatre

TRIO Gjermani | Germany

FREDERIC BELL trombon / trombone

JOHANNES FISCHER perkusione | percussion

NICHOLAS RIMMER piano

..... **Claude Debussy**

3 Songs from "Ariettes oubliées" (1888)

C'est l'extase langoureuse

Il pleur dans mon coeur

Aquarelles I (Green)

..... **Georg Aperghis (*1945)**

Le corps à corps for Zarb and spoken voice

..... **Drinor Zymberi**

Epitaphs (porositur nga REMUSICA / Commissioned by REMUSICA)

..... **Frank Martin**

Ballade for Trombone and Piano

..... **Enrique Granados**

Queja, o la maja y el ruiseñor (from Goyescas) for piano

..... **Astor Piazzolla**

Invierno Porteño (Winter in Buenos Aires)

Primavera Porteña (Spring in Buenos Aires)





REMUSICA

Fituesit e The Deutsche Musikat, Frederic Belli, Johannes Fischer (perkusion) dhe Nicholas Rimmer (piano), janë forumesit e Trio Belli-Fischer-Rimmer për koncertin e Bundesauswahl “Konzerte junger Künstler”. Që të tre muzicientët janë shpërblyer me çmime të shumëta në gara kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe kanë performuar anëmbanë botës si solistë, apo si muzicientë kamertalë.



Nicholas Rimmer është një muzicent më i njohur i muzikës kamertale dhe pianist me Leibnitz-Trio. Ai poashtu është mësimehdhënës në Universitetin e Muzikës, Dramës dhe Mediave të Hanoverit.

Johannes Fischer është professor i perkusioneve në Akademinë Muzikore të Lübeck, dhe është poashtu kompozitor dhe dirigjent.

Gjatë suksesit të tyre të jashtëzakonshëm me sezonin e koncerteve gjatë 2008/9, u bë shumë e qartë që ky kombinim i pazakontë i trombonist, pianos dhe perkusioneve do të vazhdojë, pavarësisht angazhimeve tjera të të tre anëtarëve, si solistë e muzicentë.

Trioja i kombinon me mjeshtëri epokat dhe stilet e ndryshme në programin e tyre. Ndonjëherë, duke përdorur aranzhimet e tyre, ata prezantojnë muzikë nga Bach-u të Xenakis, Debussy të Piazzolla, duke përfshirë kështu muzikën klasike, xhazin, dhe muzikën e re me *joie de vivre* muzikore, dhe duke eksploruar mundësite e shumëta të instrumenteve të tyre.

Trioja ka caktuar disa vepra të reja për sezonin 2011/12 season, prandaj do jetë interesante të shihet se çka fsheh e ardhmja për këta tre muzicentë dhe publikun e tyre, në kuptim të drejtimeve jo konvencionale përtej zakoneve tradicionale të dëgjimit.

26 MAJ
MAY 2011

E ENJTE | THURSDAY

20h00 KONCERT VOKAL | VOCAL CONCERT Kisha Katolike "Shën Ndou" | Catholic Church "St. Anthony"

FLAKA GORANCI mexosopran | mezzosoprano
BESA LLUGIQI soprano

ADMIR DOÇI kitarë | guitar

::::: **Daniel Akiva**

Jewish-spanish song cycle

La Serena

Durme durme

Como la rosa

Ya vien el cativo

Durme hermoso hijico

Ya abaxa la novia

::::: **Joaquin Rodrigo**

Aranjuez ma pensee

Romance de Durandarte

FLAKA GORANCI

::::: **Joaquin Turina**
Sevillana

::::: **Carlo Domeniconi**
Koyunbaba

ADMIR DOÇI

::::: **Fernando Sor**
4 Seguidillas

Preparame la tumba

El que quisiera amando

Muchacha, y la verguenza

Las mujeres y cuerdas

::::: **Joaquin Rodrigo**

Tres canciones espanolas

En Jerez de la Frontera

Adela

De Ronda

BESA LLUGIQI



ADMIR DOÇI

Lindur më 1982 në Tiranë. Kreu studimet në Liceun artistik "Jordan Misja" dhe në Universitetin e Arteve të Zyrihut me Prof. Anders Miolin. U diplomua në vitin 2004 dhe përfundoi masterin "performance" me rezultatet më të larta në vitin 2007. Ka ndjekur masterklase perfeksionimi me kitaristët më të famshëm botërorë si Oscar Ghigla, Alvaro Pierri, Manuel

Barrueco, Carlo Marchione, David Russell, etj. Ai ka interpretuar në shumë festivale prestigjioze ndërkombëtare, si në Musikfestwochen Braunwald (Zvicer), Festival Boswiler Sommer (Zvicer), Liechtenstein Guitar Days (Liqenshtajn) etj. Si solist ka interpretuar me orkestrat: Ensemble Stringendo, Kammerorchester Wädenswil, Junges Orchester Zürich, Kammerphilharmonie Graubünden, Neues Glarner Musikkollegium,

Zuger Sinfonietta dhe Swiss Youth Symphonic Orchestra nën drejtimin e dirigjentëve të njohur si Markus Bosch, Kai Bumann, Carlos Dominguez-Nieto, etj. Admir Doçi është fitues i 10 çmimeve në konkurse të ndryshme ndërkombëtare. Ai luan një kitarë prestigjioze të mjeshtrit Karl-Heinz Römmich dhe në kitarë me 13 tela të mjeshtrit Ermanno Chiavi.

BESA LLUGIQI

Shkollën e mesme të muzikës e mbaroi në shkollën "Prenkë Jakova" në Prishtinë pastaj vazhdoi Fakultetin e arteve në drejtimin e solokëndimit në Prishtinë. Në 2010 përfundoi Master për solokëndim në fakultetin "Kirij i Metodij" në Shkup tek prof. Maria Muratovska ndërsa aktualisht vijon vitin e fundit master në klasën e prof. mr. Ahmet Dërguti.

Më 2009 ajo mori cmimin e parë në garat mbarekombëtare "**Jorgjia Truja**" në Shqipëri dhe në po të njëjtin vitë ishte finaliste e garës ndërkombëtare "**Marie Kraja**" nga kjo garë mori ftesë nga teatri "**La Scala**" që të bëhej pjesë e "**Akademia La Scala**". Ajo mbajti masterklase me artistë të njohur si: *Josif Gjipali, Hendrik Smit, Peter Ziethen, Marilyn Schniege* etj. Aktualisht është antare e Korit të Filharmonisë Opera e Kosovës.

FLAKA GORANCI

E lindur në Kosovë më 1985, edukimin muzikor e filloi me piano. Studimet për kanto i kreu në Akademinë e Arteve në Tiranë, në klasën e prof. Suzana Frashërit ndërsa, magistraturën e kreu në klasën e prof. Tamar Rachum, në Buchmann-Mehta School of Music, të Universiteti të Tel Aviv-it, në Izrael.

Në moshën 22 vjeçare debutoi me rolin e Rosines në operën "Il Barbiere di Siviglia" të Rossinit, në Teatrin e Operas dhe Baletit në Tiranë, më pas u paraqit në rolin e Cherubinos në operan "Le nozze di Figaro" të Mozart-it, duke vazhduar me interpretimet e roleve, si: Dido "Dido and Aeneas" të Purcell-it, Dorabella "Cosi fan tutte" etj.

Flaka ka performuar nëpër shumë koncerte dhe opera, si në: Itali, NewYork, Izrael, Angli, Turqi, Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni, nën dirigjimin e emrave, si: Vittorio Parisi, Leonardo Quadri, Yishai Steckler etj. Ka performuar poashtu edhe me Filharmoninë e Ramat Hasharon - Izrael, Filharmoninë e Maqedonisë etj.



27 MAJ
MAY 2011

E PREMTE | FRIDAY

20h00 RECITAL Kisha Katolike “Shën Ndou” | Catholic Church “St. Anthony”

ROMAIN LELEU trompë | trumpet
Misbah Kaçamaku piano

:::: **Alexander Arutunian**
Scherzo de Concert

:::: **Georges Enesco**
Légende

:::: **Valton Beqiri**
Ta-ra Ta-ra Ti
(porositur nga REMUSICA / Commissioned by REMUSICA)

:::: **Maurice Ravel**
Pièce en forme d'Habanera

:::: **Alexander Goedicke**
Etude de Concert opus 49

:::: **Philippe Hersant**
Folk tunes për trompë solo

:::: **Kushtrim Gashi**
« C-is »
(porositur nga REMUSICA / Commissioned by REMUSICA)

:::: **Philippe Gaubert**
Andante et Scherzetto

:::: **Jean Baptiste Arban**
Thème Variacione Le Carnaval de
Venise





ROMAIN LELEU

Fitues i garës ndërkombëtare « Festival Musical d'Automne de Jeunes Interprètes » dhe i çmimit special për interpretim në garën « Lieksa Brass Week » në 1999, është shpërblyer në 2005 me çmimin e 3-të në garën ndërkombëtare të muzikës kamertale në Lion, dhe është prezantuar në « Classical Revelation » të Adamit.

Trashëguesi i denjë i shkollës franceze për trompetë, Romain Leleu ka preformuar në festivale dhe salla të njohura koncertesh: Festival de la Roque d'Anthéron, Festival Radio France në Montpellier, Folle Journée de Nantes, Folle Journée në Tokio, Festivalin e Saint-Denis, Festivalin në Auvers-sur-Oise, Festival de Prades, Festival Estival d'Annecy, Salle Gaveau. Ai poashtu ka luajtur si solist me Orchestre National de Lorraine, Ensemble Orchestral de Paris, Orchestre de Bretagne, Cannes, Orchestre Philharmonique de

l'Opéra de Marseille, Orchestre d'Auvergne, Colonne, Württembergisches Kammerorchester Heilbronn, Baltic Chamber Orchestra, Slovak Sinfonietta, Hermitage State Orchestra e St Petersburg në France dhe jashtë vendit: Zvicër, Belgjikë, Spanjë, Portugali, në Rumanë në Sallën Koncertale Athenum, në Estoni në Sallën Koncertale të Estonisë, Algjeri, Izrael, Kubë, Egjipt, Japoni, Kore.

Që nga 2002, Romain Leleu është « Yamaha Performing Artist » dhe laureat i Fondacionit Groupe Banque Populaire. Ai ftohet rregullisht të performojë në emisione të radios dhe TV-së, si p.sh. në France 2, France 3, Direct 8 TV, France Musique etj.

Është fitues i çmimit « Zbulimi i Solistit Instrumental » në French Classical Music Awards 2009

MISBAH KACAMAKU

U lind në Mitrovicë. Shkollën e ulët e kreu në vendlindje ndërsa të mesmen në Prishtinë.

Ne vitet 1986-1993 studion për piano në Akademinë e Muzikës "Gnjeshinih" në Moskë, Rusi në klasën e Prof. Jurij Petrov. Diplomohet në vitin 2002 në Fakultetin e Arteve në drejtim të pianos. Me 2004 përfundon me sukses specializimin në drejtimin e klasikëve Vjenez në Konservatorin "Josef Haydn"-Eisenstadt në klasën e James McCheseny.

Në vitin 2010 përfundoi studimet postdiplomike në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup në klasën e Prof. Jasmina Cakar. Si solist dhe anëtar ansamblesh ka mbajtur koncerte në Zvicër, Maqedoni, Slloveni, Spanjë, Gjermani etj.

Është bashkëpunëtor i ngushtë i Filharmonisë-Operës së Kosovës si dhe anëtar i Solistëve të Filharmonisë së Kosovës.



28 MAJ
MAY 2011

E SHTUNË | SATURDAY

12h30 KONCERT | CONCERT Kisha Katolike "Shën Ndou" | Catholic Church "St. Anthony"

KALEI DUO Itali | Italy

TITO CICCARESE flaut | flute

GIANNI FASSETTA fizarmonikë | accordion

..... **Astor Piazzolla**

Tristango
Libertango

..... **Paolo Pessina**

T-Tango për fizarmonikë / accordion

..... **Ennio Morricone**

Gabriel's Oboe

..... **Zeqirija Ballata**

Vallja e maleve (Dance of the Mountains)

..... **Massimo Di Gesu**

Miracle për flaut alto / alto flute

..... **Nino Rota**

Amarcord: Foxtrot

..... **Teresa Procaccini**

Melodia Notturna Op. 190

..... **Mario Pagotto**

Blueness Morning (Dedicated at Duo Ciccicarese-Fassetta)

..... **Richard Galliano**

Tango pour Cloude





TITO CICCARESE

Është lindur në Cesena të Italisë. Ka filluar studimet në qytetin e tij të lindjes nën drejtimin e Giovanni Gatti-t në Konservatorin "G.B. Martini" ku edhe diplomoi me sukses të madh. Pas specializimit me William Benett, Aurèle Nicolet, Patrick Gallois; me rëndësi të veçantë për zhvillimin e tij artistik ishte takimi me János Bálint, për një kohë të gjatë. I interesuar jashtë mase për literaturën italiane për flautë dhe në muzikën e dhomës në përgjithësi, ai ju bashkua disa ansambleve, me të cilat mori disa çmime në gara kombëtare (A.C.A.D.A. Genova, Curci – Barletta, A.M.A. Calabria) dhe ndërkombëtare (Stresa, Rovere d'Oro – San Bertolomeo a Mare, Tortona, Ispra, Acqui Terme). Gjatë koncerteve të tij intensive ai ka interpretuar

për asociacione të rëndësishme si (Gioventù Musicale Italiana, A.GI.MUS., Ente Filarmonico per il Mezzogiorno, Tecne Italiana Musica, Ass. Mozart Italia, Aqademia Filarmonica di Bologna etc and festivals (Estate Teatrale Veronese, Rassegna Malipiero – Asolo Musica, I suoni del Tempo – Cesena, Agnone, Pitigliano, Primavera Musicale Volterrana, Benevento Classica, Piemonte Musica, Melfi, Todì, Koszalin, Danzig, Palma de Mallorca, Salzburg, Zagreb, International Eëek of Italian Music – Craiova). Ai ka interpretuar si solist me orkestra të ndryshme dhe ka bërë koncertë në Austri, Zvicër, Francë, Gjermani, Danimarkë, Suedi, Norvegji, Finlandë, Spanjë, Ishujt Belerike, Portugali, Poloni, Latvi, Kroaci, Ruman, Bullgari, Kanada dhe SHBA (Neë York – Carnegie Hall), Rusi.



GIANNI FASSETTA

Ka filluar studimet e tij muzikore nën mbikqyrjen e Elio Boschello-s së Venedikut dhe ishte dalluar në moshë shumë të re për spontanitetin e tij teknik dhe shkathtësitë interpretative. Ai ka ndjekur kurse specializimi me F. Lips dhe W. Zubintskj. Ai ka marrë pjesë dhe është shpërblyer me vënding e parë në garant ndërkombëtare në vazhdim: Trieste, Recanati, Alassio, Stresa, Foligno, Trieste, Treviso. Ai ka interpretuar në "Fanelli Orchestra" të Miranos në shumë transmetime të RAI TV dhe turne, për të cilët ai ishte fizarmonikisti i parë dhe solist, ku gjatë një turneu

në Kanada ai mori kritika të mrekullushme nga kritikët më të njohur.

Tani, ai punon si solist në Itali (Festival dei Due Mondi-Spoleto, Sala Nervi and Università La Sapienza-Rome, Turin) dhe jashtë vendit si në Austri, Kanada, Gjermani, Zvicër, Slloveni, Suedi, Republikën Çeke, Argjentinë.

Ai është shumë aktiv edhe në muzikën kamertale dhe është pjesë e një orkestre kamertale "Mitteleuropa" të Udine-s, ai interpreton me "Piazzollando Trio" (fitues të Amadeus International Contest 2000).

Ai punon në Istituto Musicale "Santa Cecilia" në Portogruaro prej vitit 1991.



28 MAJ
MAY 2011

E SHTUNË | SATURDAY

19h30 KONCERT | CONCERT Kisha Katolike "Shën Ndou" | Catholic Church "St. Anthony"

KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS Kosova Philharmonic Choir

RAFET RUDI dirigjent | conductor

::::: **Eric Whitacre**
Lux aurumque

::::: **Eric Whitacre**
Cloudburst për Kor, Piano dhe Perkusione
for Chorus, Piano and Persussion
Elbenita Kajtazi, sopran
Artan Durmishi, bas
Shkelzen Veseli, recitues | reciter

::::: **Benjamin Britten**
A Ceremony of Carols
Adelina Paloja, sopran
Flaka Goranci, mexosoprano | mezzo

::::: **Mendi Mengjiqi**
Dam rrama dam
Riad Ymeri, tenor
BAKI JASHARI, dirigjent | conductor

::::: **John Tavener**
The Lamb
Elbenita Kajtazi, sopran

::::: **John Tavener**
Song for Athene

::::: **Thoma Simaku**
Trëndelinë

::::: **Leonard Bernstein**
Amerika
Adelina Thaqi, sopran
Djellza Sylejmani, mexosoprano | mezzo

::::: **Rafet Rudi**
Ulu mal të dalë hëna

MISBAH KAÇAMAKU,
përcjellja në piano | piano accompanist
Patris Berisha,
perkusione | persussion



Kori i Filharmonisë së Kosovës është ansambël profesional (me 50 antarë profesionist) i cili vazhdon punën e Korit profesional të ish Radio-televizionit të Prishtinës, kor i cili veproi me shumë sukses që nga viti 1980 pikërisht nën drejtimin e dirigjentit aktual të Korit - Rafet Rudit. Me aktivitetin e tij Kori i Filharmonisë gjithashtu vazhdon të kultivojë traditën e këndimit koral që në Kosovë ekziston që nga viti 1945. Programi i këtij ansambli përfshin vepra të një game të gjërë stilistike, duke filluar nga veprat e mjeshtërive të vjetër (Monteverdi, Morley, Arcadelt, Marenzio) e deri te veprat e kompozitorëve të rëndësishëm nga literatura moderne korale (B. Britten, Arvo Pärt, Eric Witacre etj.). Vend të rëndësishëm në programet e Korit zë krijmtaria e kompozitorëve kosovarë/shqiptarë. Kori, deri më tash ka pasur një sërë prezentime të rëndësishme në vend dhe jashtë Kosovës me programe a capella – si në Pula, Poreç (Kroaci), Shkup, Tiranë, Durrës etj. Në bashkëpunim me Orkestrën Simfonike të Filharmonisë, realizon vepra të mëdha vokalo-instrumentale. Kori Profesional i Filharmonisë së Kosovës paraqet bazë të rëndësishme të jetës muzikore dhe bërthamën e nevojshme në drejtim të formimit të Operës së Kosovës.

Rafet Rudi u lind në Mitrovicë më 1949. Studimet i kreu pranë Akademisë së Muzikës në Beograd. Diplomoi në degën e Dirigjimit (1973) dhe në degën e Kompozimit (1974). Studimet pasuniversitare (magjistraturën) i mbaroi në Sarajevë, kurse specializoi për një vit shkollor në Konservatorin Nacional të Parisit në klasën e kompozitorit Claude Ballif. Në periudhën 1980 -1987 ishte dirigjent permanent i Korit profesional të Radiotelevizionit të Prishtinës. Merret me publicistikë. Ka mbi 300 shkrime të ndryshme (eseistikë, recensione, kritikë etj.). Të botuar ka disa libra shkollor dhe librin teorik "Sprova estetike". Aktualisht është Profesor në Akademinë e Muzikës në Prishtinë, ku ligjëron lëndën e Formave të muzikës dhe Kompozimin. Është udhëheqës i Qendrës Kosovare për Muzikën e Re dhe Drejtor i Festivalit Ndërkombëtar të Muzikës së Re - REMUSICA.

Rudi është laureat i shumë shpërblimeve dhe mirënjohjeve (Çmimi i Dhjetorit të Kosovës për krijmtari), 1983; Çmimi i Festivalit Internacional BEMUS, 1974; Çmimi vjetor i SHKK për vitin 1982) etj. Veprat kryesore: Simfonia, Koncert për kitarë dhe orkestër harkor, Kohë koncertante për piano dhe orkestër simfonik, Kuartet harkor, The return për mexosoprano dhe orkestër simfonik, Afresk arbëresh III për sopran, kor, 2 piano, organo, recitator dhe shirit manjetik, Dialogues perdu për flautë, trio harkor dhe shirit manjetik, Rrojtja për kitarë dhe orkestër harkor, Metamorfoza për flautë, piano, mexosoprano dhe orkestër harkor, Icare ubi es për mexosoprano, kor, 3 timpani, gong, tr-gl, 2 piano, Suite për kitarë, Song of Tana për klarinet dhe piano, Kuintet "Antigonea" për flautë, clarinet, violin, fagot dhe piano, Laudatio Funebris për piano dhe orkestër harkor, Reve nostalgique - elektronike etj. Veprat i ekzekutohen në Francë, Zvicër, Britani të Madhe, Itali, SHBA, Japoni, Shqipëri, Spanjë, Suedi, Bullgari, Kroaci, Slloveni etj.



29 MAJ
MAY 2011

E DIEL | SUNDAY

20h00 KONCERT | CONCERT Salla e kuqe | Red Hall

ORKESTRA E FILHARMONISË SË KOSOVËS Kosova Philharmonic Orchestra

JOUNI SOMERO piano Finlandë | Finland

RENÉ GULIKERS dirigjent | Conductor, Holandë | Holland

::::: **Felix Mendelssohn**

Hebrides overture

::::: **Franz Liszt**

Koncert No.1 në Es-dur / Concert for Piano

::::: **Giel Vleggaar**

Dead of Disco

::::: **George Gershwin**

Cuban Overture

* Koncert i rregullt i Orkestrës së Filharmonisë



JOUNI SOMERO

Pianisti finlandez, Jouni Somero, filloi të studiojë organon që nga mosha 8 vjeçare, por kaloi në studimet për piano në moshën 12 vjeçare. Studioi piano në Zvicër, dhe në Akademinë Muzikore në Keln, me profesorin Herbert Drechsel. Nga 1981 deri në 1989, Jouni Somero jetoi në Gjermani, duke punuar si asistent në Akademinë Muzikore në Dyseldorf. Nga 1990 ai ka ndjekur

karrierën vetëm si pianist koncertal. Somero është ndër interpretuesit më të shquar në mesin e muzicentëve të tashëm finlandezë. Deri më tash, ai ka dhënë mbi 2000 koncerte anembanë botës, duke përfshirë Australinë, Japoninë, Ukrainën, Gjermaninë, Suedinë, Estoninë, Rusinë, Brazilin, Kanadën dhe Finlandën. Repertori i tij i gjerë përfshin pothuajse të gjitha veprat solistike për piano të Sergei Rachmaninov-it, dhe të Bortkiewicz-it.



Orkestra e Filharmonisë së Kosovës u themelua pas luftës së fundit në Kosovë në vitin 2000 me iniciativë të disa muziktarëve të dalluar kosovar. Fillimisht si ansambël harkor e më vonë orkestrë kamertale, Filharmonia e Kosovës paraqet padyshim vazhdimësinë e punës së ish Orkestrës Simfonike të Radio-Televizionit të Prishtinës veprimtaria e së cilës u shua me dhunë nga regjimi serb në vitin 1990. Pas konsolidimit të institucioneve shtetërore Filharmonia e Kosovës kalon në përkujdesje të Ministrisë së Kulturës. Orkestra e Filharmonisë-Operës së Kosovës realizoi një varg koncertesh simfonike dhe operistike në

kuadër të sezoneve koncertale vjetore. Në programet e orkestrës u prezantuan veprat e një mori kompozitorësh botërorë dhe atyre shqiptarë të të gjitha orientimeve stilistike. Me këtë orkestrë kanë bashkëpunuar një varg solistësh dhe dirigjentësh: Inva Mula, Tedi Papavrami, Pavel Vernikov, Kevin KennerSihana Badivuku, Bahri Çela, Antonio Gashi, Teuta Pllana, Blerim Grubi, Lejla Pula, Venera Kajtazi, Pavle Dëshpali, Ermir Krantja, Arbër Dhomi, ToshioYanagisawa, Claudio Buchler, Baki Jashari, Bajar Berisha, Desar Sulejmani, Alexander Prior etj.



RENÉ GULIKERS

Pasi studioi dirigjimin orkestral në Maastricht (Holandë), René Gulikers (1961) vijoi disa kurse dirigjimi dhe fitoi çmime në gara në Salzburg (çmimi i parë, 1985) dhe në Besançon. Shume ftesa pasuan: ai dirigjoi orkestra në Kore Jugore, Japoni, Lituani, Poloni dhe Kinë. Në Rusi ai punoi me orkestrat më të rëndësishme: Akademinë Shtetërore të Rusisë, Orkestrën Filharmonike të Moskës, të Uralit (Jekaterinburg) dhe

atë të Nizhny Novgorod. Që nga 1997, René Gulikers ka qenë mysafir i rregullt me dy orkestrat kryesore të Sllovenisë, dhe me Orquesta Sinfónica de Chile. Në shtetin e tij, Gulikers dirigjoi, pos tjerash, edhe me Filharmoninë e Holandës, si dhe me Orkestrën Kamertale Holandeze. Nga 2005 ai është profesor në Akademinë Muzikore në Hamburg (Gjermani). Por repertorit modern, Gulikers dirigjon edhe me repertorin standard të përbërë nga vepra kompozitorësh të shek. 19 dhe 20.



30 MAJ
MAY 2011

E HËNË | MONDAY

20h00 RECITAL Salla e kuqe | Red Hall

PETRIT ÇEKU kitarë | guitar

::::: **Manuel Ponce**

Sonate Romantique (Hommage Schubert)

Allegro non troppo, semplice

Andante

Moment Musical, Vivo

Allegro non troppo e serioso

::::: **Mario Castelnuovo-Tedesco**

Capriccio Diabolico (Omaggio a Paganini)

::::: **Manuel de Falla**

Homenaje pour "Le tombeau de Debussy"

::::: **Joaquín Rodrigo**

Elogio de la Guitarra

Allegro

Andantino

Allegro

::::: **Bashkim Shehu**

Sigma 3

::::: **Astor Piazzolla**

Invierno Porteño (arr. S. Assad)





PETRIT ÇEKU

Petrit Çeku lind në Prizren, ku edhe mori mësimet e para nga Luan Sapunxhiu . Ne vitin 2002 u zhvendos në Zagreb për të vazhduar studimet me prof. Xhevdet Sahatçiu. Në vitin 2003 fitoi çmimin e parë në konkursin shtetëror të Kroacisë në Dubrovnik dhe çmimin e parë në konkursin ndërkombëtar “Anna Amalia” në Weimar të Gjermanisë. Një vit më pas, ai fitoi konkursin “Emilio Pujol” në Sassari, Itali si dhe konkursin “Andrés Segovia” në Velbert, Gjermani. Poashtu në vitin 2004 përfaqësoi Kroacinë në Çmimin Evropian Muzikor për të Rinjë duke fituar çmimin e parë si dhe shpërblimin special të Shoqatës së kompozitorëve të Kroacisë për interpretimin e një vepre të një kompozitori kroat. Në të njëjtin vit u bë student i profesorit Darko Petrinjak pranë Akademisë së Muzikës në Zagreb, ku diplomoi në vitin 2008.

Për sukseset e tij si koncertues, si dhe fitoren në garën ndërkombëtare ndër të gjitha instrumentet ‘Ferdo Livadić’ në vitin 2005 u shpërblye me çmimin vjetor “Ivo Vuljević” nga Shoqëria Kroate e Rinisë Muzikore. Në vitin 2006 fitoi Medaljen e Argjendtë në konkursin Parkening në Malibu, Kaliforni dhe çmimin e dytë në konkursin “Printemps de la guitare” në Charleroi, Belgjikë. Me fitoren në konkursin “Michele Pittaluga” në Alessandria të Italisë në vitin 2007, Petrit Çeku u ngjiti si një ndër kitaristët më të dalluar të gjeneratës së re. Kompakt diskun e parë e realizoi në shtator të vitit 2008 nën markën e njohur amerikane – Naxos. Ai është vlerësuar me çmimin vjetor të Filharmonisë së Zagrebit si Muzicienti më i mirë i vitit 2008. Gjithashtu është fitues i konkursit Schadt, të organizuar nga Orkestra Simfonike e Allentown-it, SHBA.

Petrit Çeku aktualisht vijon studimet postdiplomike në klasën e kitaristit legjendar, Manuel Barrueco, në Baltimore, SHBA.



30 MAJ
MAY 2011

E HËNË | MONDAY

21h30 KONCERT MULTIMEDIAL | MULTIMEDIAL CONCERT Salla e kuqe | Red Hall

KRISTA MARTYNES Klarinetë | Clarinet, Live Electronic, Live Video SHBA | USA

::::: **Karlheinz Essl**

Sequitur for bass clarinet and live electronics | për bas klarinetë dhe elektronikë

::::: **Ana Sokolovic**

Mesh for clarinet | klarinetë

::::: **Steve Reich**

New York Counterpoint for clarinet and tape | klarinetë dhe shirit manjetik

::::: **David Lang**

Press Release for bass clarinet | bas klarinetë

::::: **Giancinto Scelsi**

Tre Studi for clarinet | klarinetë

::::: **Donika Rudi**

Butterfly Whispers (Pëshperitjet e fluturës)

for amplified bass clarinet vocal and tape | për bas klarinetë të amplifikuar, vokal dhe shirit manjetik

Rona Nishliu

::::: **Julien-Robert Legault Salvail**

Fit Into the Crowd and Refuge Primavera

Mixed piece for bass clarinet, live electronics and live video

Pjesë mikste për bas klarinetë, elektronikë dhe video

* **Julien-Robert Legault Salvail** audio-visual composer and sound technician
kompozitor audio vizuel dhe inxhinier tingulli.



KRISTA MARTYNES

Krista Martynes është klarinetiste multimediale e cila sjell një jetë të re në standard dhe në repertor. Ajo e zgjeron performansën e saj me improvizime inventive që përfshijnë audio dhe video. Ajo performon si soliste dhe si muziciante kamertale. Krista koncerton në qendrat e rëndësishme të botës.

Krista, si klarinetiste klasike dhe bashkëkohore e arrirë, ka përformuar me orkestrën innovative franko-gjermane “Orchestre des Régions Européennes”, nën dirigjimin e Konrad Von Abel. Ajo ka bashkëpunuar me Qendrën IRCAM

në Paris, në improvizime dhe elektronikë të gjallë.

Krista ka pasë mundësinë të punojë me Studion Eksperimentale të Gjermanisë, des SWR, nën drejtimin e Andre Richard.

Krista ka punuar me kompozitorë të ndryshëm bashkëkohorë, si Georges Aperghis, Pascal Dusapin, Gerard Pesson, Wolfgang Rhim, Hector Parra, Vassos Nicolai, Paul Mefano. Ajo ka luajtur në koncerte kamertale, si në NEM, Ensemble Modern, Klangforum Wien, dhe me ansamblin nga Kebeku, Ensemble Chorum

Aktualisht, Krista bashkëpunon me orkestra të ndryshme dhe punon me trion e saj, “Trio ‘86” dhe ansamblin “Clip Music”.



31 MAJ
MAY 2011

E MARTË | TUESDAY

12 h 30 **Promovim** | Promotion | ART Center
Libri "Esat Rizvanolli – kompozitor" nga Sh. Hoxha
"Esat Rizvanolli – composer" from Sh. Hoxha
Referuese | Referent: Rreze Kryeziu, muzikologe | musicologist

20 h 00 **RECITAL** Salla e kuqe | Red Hall

AKI TAKAHASHI piano, Japoni | Japan

..... **Erik Satie**

Gymnopedie No.1

..... **Toru Takemitsu**

Piano Distance

..... **Makiko Nishikaze**

Scene for Piano

..... **Drinor Zymberi**

Fragments (porositur nga REMUSICA)
(Commissioned by REMUSICA)

..... **Rafet Rudi**

Le Tombeau Oublié "Varri i qytetit të harruar"

..... **Franz Schubert**

Impromptu op.142 (D 935) No.1 f-moll

..... **Morton Feldman**

Extension 3

..... **John Cage**

Ophelia

..... **Henry Cowell**

Aeolian Harp





AKI TAKAHASHI

E lindur në Kamakura, Japoni, studimet për piano i nisi që nga mosha 5 vjeçare, me të ëmën, ndërsa më pas me Yutaka Ito, (Miss) Ray Lev, dhe George Vásárhelyi në Universitetin e Arteve të Bukura dhe Muzikës, të Tokios, prej ku edhe magjistroi.

Debutoi me performansën e veprës së Toru Takemitsu gjersa ishte ende studente. Recitalin e parë solistik e mbajti në 1970 në Tokio, ku mori mirënjohje nga kritika si interprete e muzikës së re nga kompozitorët si: Messiaen, Boulez, Xenakis, Takemitsu, dhe të tjerë.

Që nga debutimi i saj, ajo ka qenë shumë aktive me performasa të muzikës së re dhe ka punuar rregullisht anëmbanë botës, që nga recitalet e saja më 1972 në Berlin Festival Week dhe Paris Autumn Festival.

Përveç që është e njohur për mjeshtërinë e saj muzikore klasike, Takahashi është në veçanti e lavdëruar për interpretimet

imagjinative të veprave bashkëkohore; emrat si: John Cage, Morton Feldman, Isang Yun, Peter Garland, dhe vëllai i saj, Yuji Takahashi, janë vetëm disa prej kompozitorëve që kanë kompozuar për të. Me rastin e premierës amerikane të veprës 'Triadic Memories', Morton Feldman e përshkroi: "Aki Takahashi është shumë më ndryshe [nga David Tudor dhe Roger Woodward]. Takahashi duket krejtësisht e qetë. E pashqetësuar, e relaksuar, thuase e koncentruar për t'u lutur".

Ajo pranoi çmimin e parë Kenzo Nakajima (1983) dhe të parin nga Kyoto Music Award (1986).

Ka të botuara me dhjeta disqe për shtëpitë më të njohura diskografike botërore. Më 2007, ajo u shpërblye me çmimin e 58-të "Art Encouragement Prize" nga Ministria e Arsimit, Kulturës dhe Shkencës, për CD-në e saj "Schubert Piano Sonata" (Camerata Tokyo) dhe koncertin "Morton Feldman TRIO". Më 2008, fitoi çmimin meritur në Japoni Art Festival për CD-në e saj "The Perilous Night -Aki Takahashi Plays John Cage" (Camerata Tokyo).

01 QERSHOR
JUNE 2011

E MËRKURË | WEDNESDAY

12 h 30 **Koncert Pedagogjik / Miniatura për Piano** (Salla e Filharmonisë së Kosovës)

Pedagogic Concert / Miniatures for Piano (Kosova Philharmony Hall)

Në bazë të këngëve popullore shqipe (vepra të porositura nga Festivali REMUSICA)
Based on Albanian folk songs (Commissioned by REMUSICA)

Zeqirja Ballata / Dafina Zeqiri / Kreshnik Aličkaj / Drinor Zymeri / Kushtrim Gashi / Fahri Beqiri / Vasil S. Tole / Valton Beqiri / Fatos Lumani / Muhamed Bislimi

20 h 00 **KONCERT | CONCERT** Salla e kuqe | Red Hall

Ansambli SOLISTËT E ZAGREBIT Kroaci | Croatia
Ensemble | SOLISTI DI ZAGREB

..... **Antonio Vivaldi**

Four Seasons | Kater stinet e vitit

Borivoj Martinić - Jerčić, violinë | violin

..... **Ivo Josipovic**

Samba da camera

..... **Baki Jashari**

Passacaglia

..... **Leo Brouwer**

Tres danzas concertantes për kitarë dhe orkestër | for Guitar and Orchestra

Petrit Çeku, kitarë | guitar





REMUSICA

Ansambli është themeluar nga Maestro Antonio Janigro, Solistët e Zagrebit kanë punuar poashtu edhe me udhëheqës artistikë Tonko Ninić, Dragutin Hrdjok and Anđelko Krpan, zakonisht pa dirigjent. Violinisti Borivoj Martinić-Jerčić aktualisht shërben si mjeshtër koncerti dhe drejtor artistik, që nga viti 2006. Virtuoziteti i Ansambilit si dhe diciplina e tij e jashtëzakonshme krijojnë një entuziazëm dhe dashuri me të cilat ansambli luan në nivelin më të lartë.

Ansambli ka performuar mbi 3300 koncerte anembanë botës, dhe ka pranuar mirënjohje zyrtare dhe lëvdata nga kritika në vendet më prestigjioze botërore; Vienna Musikverein, Carnegie Hall, Amsterdam Concertgeboë, London's Royal Festival Hall, Berlin Philharmonic Hall, Sydney Opera House, dhe Teatro Real Madrid janë disa nga shumë emrat e njohur. Ansambli paraqitet rregullisht në festivalet ndërkombëtare të njohura të Zagrebit – pastaj në Salzburg, Pragë, Edinburg, Berlin etj. I Solisti di Zagreb poashtu kanë bashkëpunuar me shumë artistë të mëdhenj, si Henryk Szeryng, Alfred Brendel, Pierre Fournier, James Galëay, Katia Ricciarelli, Christian Ferras e shumë të tjerë.

Repertori i gjerë i ansambilit përfshin vepra të barokut, klasike, romantike, si dhe vepra bashkëkohore, si dhe kujdes të veçantë i kushtojnë veprave të kompozitorëve kroatë. Diskografia e gjerë e Solistëve të Zagrebit mund të dëgjohet nga më se 70 albume të incizuara me EMI, RCA, Vanguard, ASV, Eurodisc, Melodia, Hispa-vox, Pickëick, Croatia dhe EDI Records.

Ansambli është fitues i disa çmimeve prestigjioze, përfshirë këtu edhe çmimin e parë në Mar de Plata, pastaj Pablo Casals Medal, Elizabeth Sprague Coolidge Medal për performansën më të mirë të muzikës bashkëkohore, atë të Vladimir Nazor, çmimet Milka Trnina dhe Orlando për interpretimin më të mirë të veprave kroatë. Solistët e Zagrebit janë nderuar dy herë me shpërblimin e Qytetit të Zagrebit, dhe kanë marrë mirënjohje speciale nga UNESCO.



Pos pranimit të CD-së së argjendtë nga Croatia Records, ansambli është shpërblyer poashtu me Rendin e Nderit Kombëtar, dhe me pllakën e argjendtë të Jeunesses Musicales.

Gjatë luftës kroate për pavarësi, Solistët e Zagrebit performuan mbi 70 koncerte bamirëse për rindërtimin e Teatrit Kombëtar në Osijek, rindërtimin e spitalit të fëmijëve në Zagreb, si dhe rindërtimin e shumë shkollave muzikore, kishave dhe monumenteve tjera të shkatërruara nga lufta. Ata poashtu kanë performuar një seri koncertesh për ta festuar Republikën e re të pavarur të Kroacisë.

